

AKT - THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE “NEDO Medical” sh.p.k

Sot, më datë 03.04.2023 (dymijë e njëzet e tre) në themeluesit e shoqërisë:

- Nedion Çili, i biri i Agim dhe Elmira, lindur në datë 17/02/1993 në Korce, pajisur me Dokument Identifikimi me Nr. J30217074A, madhor me zotësi të plotë për të vepruar.

Në bazë të vullnetit tonë të lirë dhe të pakushtëzuar, në mbështetje të Ligjit Nr.9901 dt.14/04/2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, kemi vendosur të themelojmë Shoqërinë Tregtare “**NEDO Medical**” sh.p.k, sipas përcaktimeve të bërë në Akt-Themelimi dhe Statut.

Neni 1- FORMIMI

Formohet Shoqëria Tregtare me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “**NEDO Medical**” sh.p.k me nje ortakë themelues, Z. Nedion Çili

Neni 2 - SELIA

Shoqëria Tregtare “**NEDO Medical**” sh.p.k e ka selinë ligjore në Tirane : Rruga “Lord Bajron”, Ndertesa 54/3, Nr.2, Tirane, me të drejtë për të ndryshuar qendrën e saj si dhe për të hapur degë dhe filiale të tjera në të gjithë Republikën e Shqipërisë si dhe jashtë saj në përputhje me Legjislacionin Shqiptar

Neni 3 - KOHËZGJATJA

Shoqëria Tregtare “**NEDO Medical**” sh.p.k ka një kohëzgjatje të veprimtarisë së saj ekonomike të pakufizuar.

Neni 4 - OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë ekonomike i Shoqërisë Tregtare “**NEDO Medical**” sh.p.k është përcaktuar me hollësi në nenin 2 te Statutit të kësaj shoqërie. Kështu konkretisht kjo shoqëri do të ushtrojë aktivitetin e saj në fushën:

Aktivitet import-export, tregtim me shumice dhe pakice te materialeve dhe instrumentave mjekesore, dentare dhe laboratorike, ortopedike dhe suplementeve te ndryshme ushqimore, etj

Neni 5 - KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i Shoqërisë Tregtare **“NEDO Medical” sh.p.k** është **100** (njëqind) lekë, i cili është nënshkruar dhe shlyer totalisht si kapital në para. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues Z.Nedion Çili : Zoterues i 1 (një) kuote me 100 (njëqind) lekë, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6 – ADMINISTRATORËT

Shoqëria Tregtare **“NEDO Medical” sh.p.k** ka si Administrator të saj Z. Nedion ÇILI i cili ushtron dhe ndjek aktivitetin e shoqërisë duke zbatuar kompetencat përkatëse sipas statutit të shoqërisë.

Afati i emerimit të administratorit Z. Nedion ÇILI do të jetë për një afat 5 (pesë) vjeçar, duke nisur nga dita e nënshkrimit të këtij Akti.

Neni 7 – VULA E SHOQËRISË

Shoqëria ka vulën e saj zyrtare me përmbajtje:
Shoqëria Tregtare **“NEDO Medical” sh.p.k**

Neni 8 - BILANCI DHE TË ARDHURAT

Viti financiar i Shoqërisë mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti.

Në mbylljen e çdo viti financiar, Administratori i Shoqërisë bën inventarin dhe llogaritë vjetore, në përputhje me dispozitat ligjore mbi kontabilitetin, si dhe harton një raport me shkrim për administrimin.

Raporti i administrimit, inventarët dhe llogaritë vjetore të hartuara nga Administratori, i nënshtrohen miratimit të Ortakeve brenda një afati prej 6 muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar.

Neni 9 - SHPËRBËRJA E SHOQËRISË

Shpërbërja e Shoqërisë Tregtare **“NEDO Medical” sh.p.k** mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak, duke vepruar sipas kriterëve të parashikuara në Statutin e Shoqërisë.

Neni 10- DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Ky Akt themelues (kontratë) përpilohet në disa kopje për :

- Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, për të bërë veprimet në Rregjistrin Tregtar.
- Një kopje mbahet nga shoqëria si pjesë e dokumentacionit të themelimit të Shoqërisë Tregtare **“NEDO Medical” sh.p.k**

Ky akt themelimi mbyllet me 10 (dhjetë) nene.

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“NEDO Medical” sh.p.k

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

Z. Nedion Çili

Nedion Çili

